



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**

Nr. 110 / Prot.

Patos, më 22/01 /2024



**MIRATOHET  
KRYETARI  
Fation Duro**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 06, datë 22/01/2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
NDËRVENDORE PËR MENAXHIMIN E LANDFILLIT (DEPOZITIM,  
PESHIM & MIRËMBAJTJE E RRUGËS HYRËSE) NË IMPIANTIN E  
MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Mbështetur në nenet 3, 8, 9, 14, 23, 32, 33, 54 shkronja “gj”, 64 pika “c” të ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane”, ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, date 03.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane” dhe kërkesës nr. 3080 prot., datë 22.09.2023 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë, vendimin nr. 64, datë 30.10.2023 “Për dhënien e dakortësisë për marrjen në përdorim të landfillit të mbetjeve urbane të administruar nga agjencia e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara Tiranë”, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, pastrim & mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.
2. Pjesë e projektvendimit është edhe marrëveshja nr. 110 prot, datë 16.01.2024.

DR.P.U.P.SH.E.C

Boreta Murati

PËRGJ.SEKTORIT JURIDIK

Nurkë Hazizaj

DR.AGJ.SH.P PATOS

Eneo Xhaferi

DR. FINANCËS

Mimoza Shtëmbari

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Shkëlqim Begiraj



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS

Nr. 110/ Prot.  
2

Patos, më 22 01/2024

RELACION

**“PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMI NDËRVENDORE  
PËR MENAXHIMIN E LANDFILLDIT (DEPOZITIM, PESHIM, PASTRIM &  
MIRËMBAJTJEN E RRUGËS HYRËSE) NË IMPIANTIN E MBETJEVE  
URBANE TË QARKUT FIER**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Me vendimin nr. 64, datë 30.10.2023 “Për dhënien e dakortësisë për marrjen në përdorim të landfilldit të mbetjeve urbane të administruara nga agjencia e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara Tiranë” u autorizua Kryetari i bashkisë për të zhvilluar negociatat me bashkitë e qarkut për menaxhimin e landfilldit dhe më datë 16.01.2024 është nënshkruar marrëveshja “Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërvendore për menaxhimin e landëfilldit (depozitim, peshim, pastrim & mirëmbajtjen e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të qarkut Fier.

Kjo marrëveshje u lidhë ndërmjet Bashkisë Fier, Bashkisë Patos, Roskovec, Lushnje, Divjakë dhe Mallakastër.

Qëllimi i marrëveshjes është menaxhimi i përbashkët të mbetjeve urbane për sa i përket pjesës së depozitimit, peshimit dhe rrugës hyrëse në impiantin e mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe përcaktimi i një strukture të përbashkët për kryerjen e kësaj veprimtarie, duke i deleguar kompetencat dhe përgjegjësitë e veçanta dhe duke marrë përsipër angazhimet financiare të nevojshme për funksionimin e kësaj strukture.

Palët kanë rënë dakort që menaxhimi i impiantit do të kryhet nga Sektori i ngritur pranë ndërmarrjes së pastrimit të bashkisë Fier i cili ka në përbërje të tij 15 ( pesëmbëdhjetë) punonjës.

Për sa i përket kontributit financiar mujor për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e sektorit e shprehur në përqindje % për bashkinë Patos do të jetë 8.7 % dhe pagesa do të bëhet brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga marrja e faturës.

Bashkitë marrin përsipër transportin e mbetjeve me mjetet e veta nga territori i tyre apo pika e transferimit deri në vënd-depozitim pranë impiantit të mbetjeve urbane.

Pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në marrëveshje me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë marrëveshjen protokolluar pranë bashkisë Patos nr.110 prot., datë

10.01.2024 “Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimi ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, pastrim & mirëmbajtjen e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të qarkut Fier.

2. Efektet financiare do të mbulohen nga fondet e trashëguara.
3. Për ndjekje dhe zbatimin e kësaj marrëveshje ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Patos.

**Sekretar i Përgjithshëm**

Shkëlqim Bediraj

**Drejtoreshë e P. ZH. Territorit**

Boreta Murati

**Drejtoreshë e Financës**

Mimolza Shtëmbari

**Sektori Juridik**

Nurkë Hazizaj

**Drejtor i ASHP**

Eneo Xhaferi

**KRYETARI**

Fation Duro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
SEKTORI I PROTOKOLL - ARKIVËS

KARTELA SHOQËRUESE PRAKTIKËS

Dërgues Bashkia e Durrës Nr. Prot. 110, Data 16/01/2024,

Shkurtimi i lëndës Mbrojtja e kështjellave në bashki për menaxhimin e lëndës dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore

Për trajtim nga:	<u>Sek. Përgjithshme</u>
(Struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Dr. K. Marku</u> <u>Sek. Juridik</u>
Me porosi:	<u>Të përgjithshme Projekt - vendim për kështjellat bashkiake</u>

Afati:  Normal (7 ditë)  Prioritet (3 ditë)  Urgjent (brenda ditës)  Pa afat/për dje  Tjetër ditë

Data 16/01/2024, Nr. Prot. 110, Nënshkrimi: Faton Duro

Marrë në dorëzim     /     /2024

Nënshkrimi:    

Kalon për trajtim (struktura):     /     /2024,

Me porosinë:    

Marrë në dorëzim     /     /2024

Nënshkrimi:    

Kalon për trajtim (struktura):     /     /2024,

Me porosinë:    

Marrë në dorëzim     /     /2024

Nënshkrimi:    

Kalon për trajtim (struktura):     /     /2024,

Me porosinë:    

Trajtim i materialit përfunduar më:     /     /2024, Specialisti

Trajtim i materialit pranuar më:     /     /2024, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më:     /     /2024, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më:     /     /2024, Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË





Nr. 260 Prot. Nr. 433 Prot. Nr. 60 Prot. Nr. 256 Prot. Nr. 110 Prot. Nr. 199 Prot.  
Dt. 12/01/2024 Dt. 16/01/2024 Dt. 16/01/2024 Dt. 16/01/2024 Dt. 16/01/2024 Dt. 16/01/2024

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRVENDORE**

**PËR MENAXHIMIN E LANDFILLDIT (depozitim; peshim; pastrim & mirëmbajtje e rrugës hyrëse) NË IMPIANTIN E MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER**

1. Bashkia Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi,
2. Bashkia Lushnje, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Eriselda Sefa,
3. Bashkia Patos, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Fatjon Duro,
4. Bashkia Roskovec, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Majlinda Bufi,
5. Bashkia Divjakë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Josif Gorrea,
6. Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Qerim Ismailaj,

Këtu e më poshtë të referuar si "Palët",



- Në mbështetje të nenit 9, nenit 14, të Ligjit nr 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”;
- Në mbështetje të Dakortësisë dhe Autorizimit të dhënë nga Këshillat Bashkiakë përkatës për marrjen në përdorim me qera 1 (një) Euro dhe lidhjen e kontratës së Qerasë, nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë vetëm të pjesës së landfillimit – depozitimit të mbetjeve urbane, peshimit, dhe rrugës hyrëse të Impjantit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier;
- Në mbështetje të Autorizimit të dhënë nga Këshillat Bashkiakë përkatës për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe përcaktimit të një strukture të përbashkët, e cila do të kryejë për llogari të gjithë Bashkive të Qarkut Fier, menaxhimin e pjesës së depozitimit, peshimit dhe rrugës hyrëse në Impjantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier;
- Bazuar në:
  - Vendimin nr 11 datë 28.09.2023 të Këshillit Bashkiak Fier;
  - Vendimin nr 86 datë 27/10/2023 të Këshillit Bashkiak Lushnjë,
  - Vendimin nr 90 datë 31/10/2023 të Këshillit Bashkiak Roskovec,
  - Vendimin nr 64 datë 30/10/2023 të Këshillit Bashkiak Patos,
  - Vendimin nr 52 datë 27/10/2023 të Këshillit Bashkiak Divjakë,
  - Vendimin nr 66 datë 21/12/2023 të Këshillit Bashkiak Mallakastër,;
- Duke qënë se në Qarkun Fier, në fshatin Verri, Njësia Administrative Mbrostar, është ndërtuar Impianti i Përpunimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier, i cili administrohet nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë, (e cila është ngarkuar me Vendimin nr 134 dt.28.03.2022 të Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për administrimin e shoqërisë së sekuestruar “Integrated Tehnology Waste Treatment Fier” sh.p.k” ).
- Bazuar në Kontratën e Qerasë, të lidhur midis palëve të sipërmendura dhe Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë (AAPSK),;

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi ndërvendore, me kushtet dhe termat e mëposhtme:

## NENI 1

### BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të mbështetet në dispozitat ligjore të:

- Ligjit nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” të ndryshuar,
- Ligjit nr 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane” të ndryshuar,



- Ligjit nr 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara” i ndryshuar,
- Ligjit nr.68 date. 27.04. 2017 “Per Financat e Veteqeverisjes Vendore” ,
- Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë
- Ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- Udhëzimit nr. 20 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

çne akteve nënligjore të dala në zbatim tyre.

## NENI 2

### QËLLIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT



1. Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, janë përgjegjëse për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, në fushën e shërbimeve publike për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane, të krijuara në territoret në juridiksionin përkatës të secilës palë, në dobi të komuniteteve dhe në funksion të rimbrotjes dhe garantimit të interesit publik.
2. Kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor ka si qëllim , menaxhimin e përbashkët të mbetjeve urbane përsa i përket pjesës së depozitimit, pesimit dhe rrugës hyrëse në Impjantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier, dhe përcaktimin e një strukture të përbashkët për kryerjen e kësaj veprimtarie, duke i deleguar kompetencat dhe përgjegjësitë e vecanta, dhe duke marrë përsipër angazhimet financiare të nevojshme për funksionimin e kësaj strukture.

## NENI 3

### MËNYRA E REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

#### NDËRVENDOR

1. Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, bien dakord, që fusha e depozitimit të mbetjeve urbane, në Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier, (e marrë në administrim pr. j tyre me qera 1 (një) Euro, nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë) të menaxhohet nga një strukturë e vecantë - **SEKTOR-** e ngritur pranë **NDËRMARRJES SË PASTRIMIT TË BASHKISË FIER**.
2. Emri strukturës së përbashkët të jetë **“SEKTORI I MENAXHIMIT TË VENDDEPOZITIMIT TË MBETJEVE URBANE NË IMPJANTIN E MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER”**
3. Palët nënshkruese marrin përsipër ti delegojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e vecanta **NDËRMARRJES SË PASTRIMIT TË BASHKISË FIER**, duke marrë përsipër angazhimet e nevojshme



financiare për funksionimin e SEKTORIT, bazuar në objektin e veprimtarisë së sektorit, dhe sasisë së mbetjeve urbane që do të depozitohen nga secila palë.

4. Objekt i veprimtarisë së SEKTORIT, do të jetë menaxhimi i mbetjeve urbane përsa i përket pjesës së depozitimit, peshimit pastrimit dhe mirëmbajtjes së rrugës hyrëse në Impjantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier, në emër dhe për llogari të bashkive të Qarkut Fier, palë nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.
5. Veprimtaria e SEKTORIT do të ushtrohet vetëm në vend-depozitimin (landfillin) në Impjantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier me vendndodhje në fshat në Verri, Njësia Administrative Mbrostar
6. Palët bien dakord që ky SEKTOR, për ushtrimin e objektit të veprimtarisë, të ketë në përbërje 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës sipas strukturës së mëposhtme:
  - Përgjegjës sektori 1 (një)
  - Manovratorë 2 (dy)
  - Punonjës peshimi 4 (katër)
  - Punëtorë të fushëdepozitimit (landfilli) 8 (tetë)

#### NENI 4

#### AFATI I MARRËVESHJES.

1. Palët bien dakord që kjo marrëveshje bashkëpunimi të ketë vlefshmëri për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës së qerasë 1 (një) Euro, të lidhur Bashkive të Qarkut Fier dhe Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë (AAPSK).
2. Palët bien dakord që kjo marrëveshje bashkëpunimi të jetë në fuqi edhe përtej afatit të vlefshmërisë së kontratës së qerasë të sipërpërmendur, deri në përfundimin e dorëzimit të Impiantit të Përbërimit të Mbetjeve Urbane, tek Bashkitë e Qarkut Fier, apo tek subjekti juridik i kompetencave të përbashkëta të krijuar me marrëveshje prej tyre, duke u kushtëzuar vetëm prej administrimit dhe përdorimit prej Palëve, të vend-depozitimit (landfillit) të mbetjeve urbane tek Impjanti i Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier

#### NENI 5

#### MËNYRA DHE MASA E KONTRIBUTIT FINANCIAR TË PALËVE

1. Palët bien dakord të kontribuojnë bashkarisht për mbulimin e shpenjimeve të nevojshme për funksionimin e SEKTORIT të Menaxhimit të Vend-depozitimit të Mbetjeve Urbane në Impjantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier, të ngritur pranë NDËRMARRJES SË PASTRIMIT TË BASHKISË FIER.







2. Masa e kontributit mujor të secilës palë do të përcaktohet në varësi të sasisë së mbetjeve që do të depozitohen në landfilld.
3. Sasia mujore e mbetjeve të depozituara do të përcaktohet mbi bazën e dokumentacionit ditor të peshimit që do të dorëzohet çdo ditë përfaqësuesit të caktuar nga secila palë nënshkruese për mbikqyrjen e këtij procesi. Një kopje e çdo fletë-peshimi, e kundërfirmosur nga përfaqësuesi i secilës palë, mbahet nga Ndërmarrja e Pastrimit e Bashkisë Fier, për të kryer përlogat e shpenzimeve dhe kontributit mujor financiar të secilës palë nënshkruese të marrëveshjes.
4. Mbështetur në sasinë e mbetjeve të depozituara nga secila prej palëve gjatë gjithë vitit 2023, dhe dokumentacionit të peshimit të administruar prej shoqërisë ITWT sh.p.k në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pastrimit të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë (AAPSK), palët bien dakord që masa e Kontributit Financiar Mujor të secilës palë, për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e SEKTORIT e shprehur në përqindje (%) të jetë si më poshtë:

- Bashkia Fier 46.5% të shpenzimeve totale mujore
- Bashkia Lushnje 29% të shpenzimeve totale mujore
- Bashkia Patos 8.7% të shpenzimeve totale mujore
- Bashkia Divjakë 8.3% të shpenzimeve totale mujore
- Bashkia Roskovec 7.5% të shpenzimeve totale mujore
- Bashkia Mallakastër 0% të shpenzimeve totale mujore (duke qënë se kjo Bashki nuk ka filluar ende procesin e depozitimit të mbetjeve në landfilld)

5. Palët bien dakord që çdo tre muaj, mbi bazën e dokumentacionit të peshimit të administruar prej tyre, të rishikojnë masën e kontributit financiar mujor të përcaktuar më sipër.
6. Shpenzimet e nevojshme (***Shpenzimet totale mujore***) për funksionimin e SEKTORIT të Menaxhimit të vend-depozitimit të mbetjeve urbane të cilat do të mbulohen bashkërisht nga Palët sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të këtij neni, do të përfshijnë kryesisht shpenzimet e parashikuara në aneksin bashkangjitur marrëveshjes, si dhe shpenzime të tjera të ndryshme, që mund të dalin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së menaxhimit të mbetjeve urbane, dhe që janë të pabarandura objektivisht të parashikohen në momentin e përpilimit të Aneksit bashkangjitur Marrëveshjes.
7. Palët bien dakord që në lidhje me zërin e shpenzimit Karburant, të kenë të drejtë që të kontribuojnë jo vetëm në vlerë monetare por edhe në natyrë, duke ofruar sasinë taktike të karburantit, sipas përqindjes (%) të përcaktuar më sipër.
8. Duke qënë se për kryerjen e procesit të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve në landfilld, është i nevojshëm, një mjet teknologjik (*skrep, buldozer, traktor, apo ekuivalent i tyre*), **palët autorizojnë**




Ndërmarrjen e Pastrimit të Bashkisë Fier, të kryejë në emër dhe për llogari të gjitha Palëve, procedurat ligjore të marrjes me qera të një mjeti teknologjik, duke marrë përsipër që kostot e nevojshme për kryerjen e këtij shpenzimi mujor, ti mbulajnë dhe ti mbulojnë bashkarisht sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të kësaj neni

9. Ndërmarrja e Pastrimit të Bashkisë Fier, mbi bazën e dokumentacionit që do të administrohet nga Përgjegjësi i SEKTORIT, do të përgatisë koston mujore të shpenzimeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së SEKTORIT, dhe do të informojë zyrtarisht secilën palë, duke i dërguar dhe faturën përkatëse për arkëtim të kontributit financiar takues të secilës palë për mbulimin shpenzimeve të sipërpermendura.
10. Sasia e mbetjeve që do të depozitohen, do të konfirmohet në rastin e mbërritjes prej tyre pranë Zonës së Trajtimit të Mbetjeve në Impjantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier,. Kjo sasi do të peshohet në castin e mbërritjes së mjetëve të transportit të secilës palë, nëpërmjet peshores së ndodhur në këtë zonë, duke peshuar fillimisht mjetet transportuese me ngarkesë dhe më tej mjetin e shkarkuar, për të llogaritur saktësisht sasinë e depozituar.
11. Nëse kjo procedurë nuk do të jetë e mundur për shkaqe teknike, sasia do të llogaritet manualisht, duke pasur njohuri mbi kapacitetin e mjetit të transportit, ose në një mënyrë tjetër, sikurse përfaqësuesit e secilës palë nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, do të bien dakord në momentin e depozitimit, me punonjësit e SEKTORIT dhe drejtuesit e Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier.
12. Në momentin e depozitimit të ngarkesave të mbetjeve të transportuara dhe të sjella pranë Vend-depozitimit të Mbetjeve Urbane në Impjantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier, nga përfaqësuesit e secilës Palë do të plotësohen të gjithë formularët standartë të procedurës së depozitimit.

## NENI 6

### MËNYRA E PAGESËS SË KONTRIBUTIT FINANCIAR TË PALËVE

1. Palët bien dakord të kryejnë pagesën e kontributit financiar të përcaktuar në nenin 5, brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga marrja zyrtarisht e faturës për arkëtim të lëshuar nga Ndërmarrja e Pastrimit të Bashkisë Fier.
2. Pagesa e kontributit financiar mujor nga secila palë nënshkruese e kësaj marrëveshjeje, do të kryhet sipas Faturës për Arkëtim, në numrin e llogarisë të Bashkisë Fier 2111001 llogaria ekonomike 7411099, Degë e Thesarit 0909



## NENI 7

### TË DREJTA T DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Secila palë nënshkruese e kësaj marrëveshjeje, merr përsipër detyrimin për kryerjen e transportit me shpenzimet e vetë dhe mjetet që secila palë disponon, të mbetjeve urbane të grumbuluara nga territori i Bashkive apo pika e transferimit deri në në Veril-depozitimin pranë Impiantit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.
2. Secila Palë merr përsipër detyrimin dhe cdo përgjegjësi që mund të lindë, për të qënë e pajisur vetë, ose nëpërmjet nënkontraktorëve me licencë të tipit III.2.B, për transport të mbetjeve për destinacionin Impjanti i Trajtimit të Mbetjeve të Qarkut Fier.
3. Secila palë do të paraqesë dhe do të vendosë në dispozicion të SEKTORIT dhe Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier, listën e mjeteve me targat përkatëse, që do të kryejnë transportin e mbetjeve, duke përcaktuar edhe gjeneralitetet, numrin personal të identitetit të drejtuesit të mjetit, të cilët do të marrin në dorëzim dhe do të firmosin procesverbale dhe cdo dokumentacion tjetër që do të përgatitet prej punonjësve të SEKTORIT, apo Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier.

Kjo listë do të jetë e firmosur dhe e vulosur nga secila palë nënshkruese, dhe do të bashkëngjitet Marrëveshjes dhe do të konsiderohet si pjesë integrale e saj.

4. Secila Palë ka detyrimin të përcaktojë personin përgjegjës për të gjitha komunikimet, referuar kësaj marrëveshjeje, marrjen në dorëzim dhe firmosjen e pranimit të faturave, akt-rakordimeve mujore, kryerjen e procesit të peshimit dhe llogaritjes së sasive të depozituara, si dhe shkëmbimin e cdo dokumentacioni tjetër të nevojshëm.

Ky komunikim i dërgohet zyrtarisht SEKTORIT dhe Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier, dhe do të bashkëngjitet Marrëveshjes dhe do të konsiderohet si pjesë integrale e saj.

Të dhënat që do të deklarohen zyrtarisht për personin përgjegjës të secilës palë janë: Emër Mbiemër, adresa e-mail, nr tel celular.

5. Personi zyrtar i kontaktit për komunikimet me Sektorin dhe Ndërmarrjen e Pastrimit të Bashkisë Fier do të jetë:

- **Fatjon Elezaj – Drejtues I Ndërmarrjes së Pastrimit**
- **E-mail: [nder.pastrimifier@gmail.com](mailto:nder.pastrimifier@gmail.com)**
- **Nr tel celular: 0686080070**

6. Secila Palë ka detyrimin të njoftojë të paktën 24 orë përpara, nëpërmjet e-mailit zyrtar, Sektorin dhe Ndërmarrjen e Pastrimit të Bashkisë Fier, për cdo ndryshim të mjeteve transportuese, apo drejtuesve të




këtyre mjeteve, duke deklaruar ar gat, të dhënat e drejtuesve, dhe cdo të dhënë tjetër të kërkuar për mjetet zëvendësuese.

7. Secila palë garanton se depozitimi i mbetjeve nga mjetet në pronësi dhe/ose në përdorim të saj, do të bëhet në vendin e caktuar për depozitim brenda Impjantit të Trajtimit të Mbetjeve të Qarkut Fier.
8. Në rast se nga ana e përfaqësuesve të Sektorit apo të Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier, do të konstatohen depozitim të mbetjeve jashtë vendit të caktuar, duke shkelur normat e përcaktuara nga legjislacioni për mjedisin, do të njoftohet menjëherë pala përkatëse (përfaqësuesit apo mjetet e së cilës kanë kryer shkeljen). Në keto raste, pas depozimit të njoftimit zyrtar, mjeti dhe drejtuesi shkelës, nuk do të lejohen të kalojnë më në të ardhmen në territorin e Impjantit të depozitimit të mbetjeve. Në këtë rast palët shkelëse, do ti faturohen shpenzimet e kryera për rregullimin dhe sistemin e situatës dhe eliminimin e shkeljes së kryer.
9. Secila Palë ka të drejtën të kërkojë dhe të njihet me cdo dokumentacion të administruar nga Ndërmarrja e Pastrimit e Bashkisë Fier, dhe Sektori i menaxhimit të mbetjeve urbane, dhe çdo shpenzim të kryer për realizimin e objektit të veprimtarisë së SEKTORIT.
10. Secila Palë, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar të saj, ka të drejtë të asistojë dhe të mbikqyrë procesin e peshimit, dhe cdo aktivitet tjetër që gjeneron shpenzime për kryerjen e veprimtarisë së SEKTORIT, për të shmangur cdo dyshim, apo pretendim të mundshëm, në lidhje me faturën mujore për arkëtim të kontributit financiar mujor të secilës palë
11. Cdo 3 (tre) muaj, Palët mbajnë dhe firmosin AKT -RAKORDIMIN përkatës mbi bazën e dokumentacionit të peshimit të administruar prej tyre, me anën e të cilit të rishikojnë masën e kontributit financiar mujor të secilës Palë, të shprehur në përqindje (%) për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e SEKTORIT, duke përcaktuar masën e ndryshuar të kontributit financiar mujor për 3 (tre) mujorin pasardhës.

## ENI 8

### DISPOZITA TË FUNDIT

1. Palët marrin përsipër të zbatojnë kushtet e kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, dhe me mbi bazën e parimit të mirëbesimit, ligjshmërisë dhe transparencës.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin, do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve.
3. Nëse ky mirëkuptim nuk do të arrihet, Palët do ti drejtohen për ndërmjetësim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, dhe më pas Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Qarkut Fier.



4. Cdo ndryshim i kushteve të kësaj marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim, nëpërmjet një amendamenti të nënshkruar nga secila Palë, përndryshe do të konsiderohet i pavleshëm.
5. Marrëveshja hyn në fuqi dhe bëhet e zbatueshme pasi nënshkruhet nga Palët, miratohet nga Këshillat Bashkiakë përkatës së Secilës Palë, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut Fier brenda afateve të përcaktuara me ligj.
6. Kjo marrëveshje hartohet në 10 kopje, me të njëjtën vlerë juridike, ku secila palë, merr 1 (një) kopje, për depozitim në Institucionin e Prefektit 1 (një) kopje, për depozitim në Drejtorin e Thesarit 1 (një) kopje, për Ndërmarrjen e Pastrimit të Bashkisë Fier një kopje, si dhe pasi u lexua, e u kuptua, nënshkruhet dhe vulloset nga palët pjesëmarrëse.

1. **Bashkia Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi,**

*Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)*




2. **Bashkia Lushnje, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Erielda Sefa,**

*Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)*




3. **Bashkia Patos, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Fatjon Duro,**

*Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)*



4. **Bashkia Roskovec, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Majlinda Bufi,**

*Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)*



5. **Bashkia Divjakë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Josif Gorrea,**

*Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)*



6. **Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Qerim Ismailaj,**

*Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)*



**ANEKSI MARRVESHJES SE BASHKEPUNITIT NDERVENDOR PER  
PARASHIKIMIN E SHPENZIMEVE KYRESORE/MUJORE PER ADMINISTRIMIN E  
LANDFILLIT TE MBETJEVE URBANE.**

Struktura e domosdoshme per funksionim:


Planifikimi I pagave per 12- mujorin e Vitit 2024 i Sektorit te Landfillit te Mbetjeve												
Nr	Emertimi	Numri persc.	Paga		Pozicioni i punes	Rritje ne ore nate	Paga		5%	Totali me 5% shoq.	Sigurimi 16.7% e pagese	Totali bruto +601
			per diplome	vjetersi			totale per nje muaj	Paga 12-mujore				
1	Pergjegjes sektori	1	14,000	7,000	59,400	5,000	85,400	1,029,924		171,998	1,201,921	
2	Manovrator	2		8,000	65,000	5,000	156,000	1,872,000		312,624	2,184,624	
3	Punonjës peshore	4		8,000	40,000	5,000	212,000	2,544,000		424,848	2,968,848	
4	Punetor landfilli	8		8,000	40,000	5,000	424,000	5,088,000		849,696	5,937,696	
Gjithsej		5	14,000	31,000	204,400	20,000	878,400	10,533,924		1,759,166	12,293,089	

- Shpenzime e domosdoshme mujore. ( Vlerat jane marre te peraferta me ato qe ka Agjencia momentalisht).

Zerat e shpenzimeve	Lloji i shpenzimit	Vlera (e perafert/ 1- muaj)	Vlera per 12- muaj
Karburant	Naftë (4.500- litra*200leke)	900.000 ( ne muaj )	10,800,000
Vaj	Vaj motorri 300 l Vaj Hidrauliku 200 l	13.500 (ne muaj ) 7.200 (ne muaj )	162,000 86,400
Filtra	4 Filtra Ajri 4 Filtra Vaji Hidrauliku 4 Filtra Naftë		40,000 60,000 18,000
Shpenzime per energjine e elektrike sipas pikelidhjes se re qe do te jete vetem per landfillin.			
Shpenzime per mirembajtjen e peshores.			
Marrje me Qera	Mjete	600.000 (ne muaj)	7,200,000
<b>Vlera Totale</b>		<b>1,900,000</b>	<b>18,366,400</b>

- Tabela me shpenzimet totale mujore.

Struktura e domosdoshme	15 (punonjës)	12,293,089
-------------------------	---------------	------------



Shpenzimet e domosdoshme	6- zera	18,366,400
<b>TOTALI</b>		<b>30,659,489</b>

**Shenim:**

- Per pozicionet e strukturese te domosdoshme eshte bere llogaritja sipas pages baze per pozicion.
- Per shpenzimet e domosdoshme mujore eshte referuar sipas shpenzimeve aktuale te Agjencise.
- Palet bijen dakort qe te mbulojne edhe shpenzime te tjera te ndryshme qe mund te dalin gjate ushtrimit te veprimtarise se menaxhimit te Mbetjeve Urbane dhe qe jane objektivist te pamundura te parashikohen ne kete aneks.





